KËRKESË
Nr. 267/3, datë 11.4.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga projekti 'Sistemimi i hapësirave publike dhe parkim, Lagjja e Re, blloku pas ish-Bashkisë Patos'", me vlerë totale paraprake të shpronësimit 3,490,235.1 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë një) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Patos.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vënë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

Për pasuritë e llojit "arë" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

- Për pasuritë e llojit "ndërtesë" është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Patos, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **3,490,235.1 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë një) lekë**.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA PROJEKTI "SISTEMIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE PARKIM, LAGJJA E RE, BLLOKU PAS ISH-BASHKISË PATOS"

Nr.	TË DHËNAT PËR PRONARIN												Gjendja juridike
	Emri i pronarit	ZK	Nr. i pas.	Sip. totale e truallit (m^2)	Sip. e prekur e truallit (m^2)	Çmimi i truallit (lekë/m^2)	Vlera e truallit (lekë/m^2)	Funksioni i godinës	Sip. e ndërtesës (m^2)	Sip. e prekur e ndërtesës (m^2)	Vlera e ndërtesës (lekë)	Vlera totale (lekë)	
1	Arben Uka	2890	8/57	80	80	2848	227,840.00	Shërbim	80	80	1,599,152.10	1,826,992.10	Vërtetim hipotekor
2	Andi Bregasi	2890	8/67+1-1	0	0	2848	-	Apartament	63.8	63.8	1,498,059.00	1,498,059.00	Vërtetim hipotekor
3	Shtet	2890	8/309	71	71	0	-	-	0	0	0	-	Pasuri e okupuar nga Natasha Hoxha (Petrit Hoxha)
4	Shtet	2890	8/310	70	70	0	-	-	0	0	0	-	Pasuri e okupuar nga Ganimete Alushaj
5	Jemine Mucaj	2890	8/23-N1	58	58	2848	165,184.00	-	0	0	0	165,184.00	Vërtetim hipotekor
6	Shtet	2890	8/315	123	123	0	-	-	0	0	0	-	Pasuri e okupuar nga Agako Cano dhe Hysen Qose
Vlera totale												**3,490,235.10**	

Vlerësimi për pasuritë e llojit "truall" është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
Vlerësimi i objektit "godinë" është bërë në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.